

■ Arben Ahmetaj: Asnjë tolerim për detyrimet e papaguara nga bizneset pas 2014

## Qeveria merr "Ok" nga FMN për amnistinë fiskale, fshihen të gjitha borxhet deri në 2010, falje me kusht për periudhën 2011-2014

Qeveria shqiptare ka gjetur dakordësinë e Fondit Monetar Ndërkombëtar për faljen e plotë dhe të pjesshme për bizneset që kanë detyrime të papaguara tatimore dhe doganore, gjë që si dhe kamatëvonesat. Kjo është konfirmuar nga Ministri i Financave, Arben Ahmetaj, pas kthimit nga Uashingtoni, ku pati takime me zyrtarë të FMN. Zbatimi i saj parashikon faljen e detyrimeve të vjetra doganore dhe tatimore të biznesit për periudhën deri në dhjetor 2010. Kurse për vitet 2011 deri në 2014 falja do të bëhet sipas një skeme që parashikon faljen e një pjese të detyrimeve apo penaliteteve. "Do të jetë një fshirje në traditën e fshirjes së borxheve deri në 31 dhjetor të 2010, ndërsa nga janari i 2011 deri në dhjetor 2014 do përdorim instrumentin pak a shumë që FMN ka lejuar të përdoret në Kosovë, që është një lloj incentivimi, paguaj principalin që të hiqen interesit dhe gjobat, por për periudhën deri në 31 dhjetor 2014, 2015, 2016 asnjë gjë nuk ndryshon. Detyrimet e vëna, interesat e kalkuluara, të gjitha do të mblihen me ligj. Jemi duke folur për atë pjesë që kemi rënë dakord me FMN dhe shumë shpejt do ta kemi publik të shkruar. Dua të sqaroj të gjithë sipërmarrjen që do tra-



jtohet deri në 31 dhjetor 2010 me fshirjen dhe nga 1 janari 2011 deri në 31 dhjetor 2014 me atë incentivim. Pra, me konceptin paguaj principalin, detyrimin, që të ulët interesi dhe gjoba. Nëse nuk e paguan, automatikisht je objekt i mbledhjes me forcë", pohoi ministri i Fi-

nancave, Arben Ahmetaj, në lidhje me amnistinë fiskale. Ministri u tregua i rezervuar, sa i përket përfshirjes që do të ketë falja për individët, kjo e lidhur me pjesën e detyrimeve për automjetet. Lidhur me këtë, Ahmetaj u shpreh se do bëhej e ditur pasi drafti të ishte gati.

Do të jetë një fshirje në traditën e fshirjes së borxheve deri në 31 dhjetor të 2010, ndërsa nga janari i 2011 deri në dhjetor 2014 do përdorim instrumentin pak a shumë që FMN ka lejuar të përdoret në Kosovë, që është një lloj incentivimi, paguaj principalin që të hiqen interesit dhe gjobat...

### FMN: Të fshihen vetëm borxhet e pambledhshme

Fondi Monetar Ndërkombëtar është shprehur që në fillim kundër paketës së plotë fiskale për biznesin, e hartuar së fundmi nga qeveria shqiptare. Përfaqësuesi i zyrës së përhershme të FMN në

Shqipëri, Jens Reinke pohoi pak ditë më parë se FMN ishte dakord vetëm për fshirjen e borxheve të pambledhshme, ndërsa po diskutohej për pjesën tjetër të propozimeve. "Duhet procedura të qarta për fshirjen e detyrimeve që nuk mund të mblihen më, që u përkasin bizneseve që janë mbyllur, apo atyre që nuk kanë më aftësi paguese", u shpreh Reinke. Ndërkohë, për kompanitë që janë në çështje gjyqësore me administratën tatimore, FMN ka rekomanduar gjetjen e zgjidhjeve jashtë gjykatës. Në këndvështrimin e FMN, në propozimet e qeverisë shqiptare kishte disa elementë pozitivë dhe disa elementë të diskutueshëm. Drafti paraprak i Financave parashikonte që gjobat dhe detyrimet e para vitit 2011 të fshiheshin pa kushte, ndërsa ato të pas vitit 2011 të faleshin 30% së bashku me gjobat, me kushtin që të paguhej pjesa tjetër e detyrimit. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, borxhi tatimor është 1.4 miliardë dollarë, nga i cili rreth 350 milionë dollarë i përkasin periudhës deri më 31 dhjetor 2011. Pjesa tjetër, janë detyrimet e pas 1 janarit 2012. FMN ka shprehur jo pak dhe shqetësimin se procesi i faljes mund të ketë efekt negativ në rendimentin e të ardhurave tatimore e doganore.

## SiCRED - 8 mujori - e vetmja me rritje nga shoqëritë e sigurimit të Jetës, dëmshpërblen me 105.000 Euro pilotët e rënë në krye të detyrës

2016 - Viti i Sigurimit të Jetës dhe Kursimit - SiCRED me fokus te produktet financiare

Shoqëria e Sigurimit të Jetës SiCRED sh.a., ka dëmshpërblyer familjarët e dy pilotëve të rënë në detyrë, sipas marrëveshjes siguroese me Ministrinë e Mbrojtjes. Në datën 6 prill 2016, helikopteri i forcave të armatosura në të cilin udhëtonin 3 ushtarakë është rrëzuar në liqenin e Shkodrës, duke u marrë jetën 2 pilotëve.

Dy pilotët rezultojnë të siguar, sipas Kontratës së Sigurimit "Për Sigurimin e jetës së efektivit fluturues", të lidhur midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe Bashkimit të Operatorëve. Bazuar në këtë kontratë, SiCRED sh.a. ka paguar shumën prej 14.4 milion lekë në favor të familjarëve të ushtarakëve të rënë. Kjo është hera e parë që SiCRED sh.a. bën një pagesë e tillë për pjesëtarët

e Forcave të Armatosura që humbin jetën në krye të detyrës, duke qenë pranë familjarëve të ushtarakëve, për të lehtësuar mungesën e thellë të lënë pas nga ndarja e parakohshme nga jeta e të dashurve të tyre.



**SiCRED rreth 25% të Tregut e Sigurimit të Jetës në mbyllje të 8-mujorit**

SiCRED ka patur një aktivitet të suksesshëm gjatë vitit 2016. Krahasuar me 8-mujorin e vitit 2015, vetëm SiCRED pati rritje të primeve të shkruara në tregun e sigurimit të jetës, me një rritje të vëllimit të primeve të shkruara bruto prej 7.3%.

Kjo performancë pozitive ka rezultuar dhe në përmirësimin e pjesës së tregut të SiCRED, e cila ka arritur në 25%, krahasuar me 22% të së njëjtës periudhë të vitit 2015.

**Produkte sigurimi për përfitimeve financiare afatgjata**

Misioni i SiCRED është të



jetë partneri kryesor financiar për individin, duke e shoqëruar atë përgjatë gjithë jetës, nëpërmjet ofrimit të produkteve të sigurimit të përshtatshme me kërkesat dhe nevojat e individit në çdo fazë të jetës së tij. Gjatë vitit 2016, SiCRED është fokusuar në ofrimin e produkteve të sigurimit me element kursimi afatgjatë, të cilat i mundësojnë të siguarit përfitime dyfishe: sigurim dhe kursim.

Sigurimi i Jetës (me Mbijetesë), i prezantuar vetëm pak muaj më parë nga SiCRED, ga-

ranton për të siguarin një shumë monetare (Shuma e siguruar) e cila është e pagueshme në rast vdekje apo mbijetesë. Bashkë me këtë sigurim, individit mund të zgjedhë dhe sigurimet shtesë nga aksidentet dhe sëmundjet kritike. SiCRED është e para kompani sigurimi në treg që ofron kombinimin e sigurimit të jetës afatgjatë me element kursimi me sigurimin nga sëmundjet kritike, një sigurim i cili i ofrontë siguarit një shumë monetare në rast tëshfaqjes së një prej sëmundjeve

kritike (sëmundje të rënda), gjatë periudhës së sigurimit. Kështu, i siguarit do të ketë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar kurimin e tij, pa vënë në rrezik planet e tjera financiare të familjes.

Në Sigurimin e Jetës (me Mbijetesë), pjesa e primit të sigurimit që kursehet rregullisht, investohet me një normë minimale të garantuar prej 1.2%. Në një kohë kur depozitat në monedhë të rënda si Euro apo Dollarë Amerikanë, kanë një normë interesi pothuaj 0% e në disa

raste edhe negative, ky produkt paraqet një alternativë shumë të mirë investimi afatgjatë. Gjithashtu, produkti i sigurimit i jep të drejtën individit të marrë pjesë dhe në fitimin e realizuar nga kompania për portofolin e këtij produkti, duke maksimizuar përfitimet e individit nga ky sigurim.

Këto produkte sigurimi ju ndihmojnë të jetoni sot më të qetë dhe të lumtur dhe të ndërtoni të ardhmen tuaj ashtu siç ju e imagjiloni. Duke investuar shumën të vogël sot në formën e primit të sigurimit, produkti i sigurimit mundëson të keni një shumë të madhe parash nesër, pikërisht atëherë kur ju nevojitet.

SiCRED garanton klientët e saj se në vijim do të ndërmarë fushata edukimi intensive nëpërmjet burimeve të saja për edukimin e konsumatorit shqiptar në lidhje me përfitimet që klientët e saj kanë nga produktet e Sigurimit, e veçanërisht produktet financiare.